

VENDIM
Nr. 1033, datë 16.12.2015

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE FIKSE TË ENERGIJISË, QË DO T'U PAGUHEN PRODHUESVE TË ENERGIJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15, pika 1, e 27, pika 2, të ligjit nr. 138/2013, "Për burimet e energjisë së rinovueshme", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Metodologjia e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet, është, si më poshtë vijon:

"Çmimi i shitjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent /kWh X koeficientin 1.24 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.

- Me çmim mesatar të vitit përkatës të bursës hungareze HUPX të energjisë elektrike kuptohet:

Çmimi vjetor mesatar i ponderuar, final i shlyerjes (final settlement price) së energjisë elektrike në bazë (baseload), i produkteve të livruara në segmentin e kontratave fizike të së ardhmes (Physical Futures – PhF) të bursës së Hungarisë HUPX, ashtu siç publikohet në raportin vjetor (Physical Futures Annual Report) të këtij segmenti, për vitin përkatës.

- Koeficienti 1.24 do të llogaritet për përcaktimin e çmimit të energjisë së prodhuar nga hidrocentralet dhe merr në konsideratë:

i) reduktimin e humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, si pasojë e furnizimit të energjisë elektrike në pikat e lidhjes së këtyre hidrocentraleve me rrjetin energjetik të tensionit të lartë dhe/ose të mesëm;

ii) kostot e shmangura të transmetimit të energjisë nga importi;

iii) kostot e alokimit të kapaciteteve të interkoneksionit;

iv) nxitjen e shfrytëzimit të burimeve të rinovueshme deri në arritjen e objektivave të detyrueshëm kombëtarë për pjesën e energjisë së përdorur nga burime të rinovueshme të energjisë në konsumin përfundimtar bruto të energjisë, në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimtërisë për Burimet e Rinovueshme të Energjisë.

- Me normë mesatare të shkëmbimit euro/lekë të vitit të fundit kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit nga euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin përkatës.”.

2. Deri në miratimin e çmimit të shitjes së energjisë së prodhuar nga prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike sipas këtij vendimi për vitin 2016, ERE merr masa që të përcaktojë një çmim që do të aplikohet për një periudhë të ndërmjetme, në zbatim të vendimit nr. 125, datë 11.2.2015, të Këshillit të Ministrave. Diferencat që mund të rezultojnë, ndërmjet çmimit të miratuar për vitin 2016 dhe çmimit të miratuar për periudhën e ndërmjetme, do të sistemohen nëpërmjet korrigjimit të faturimeve përkatëse.

3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama